

UDHËZIM
Nr.5, datë 30.6.2010

**PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR.1, DATË 13.6.2000 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR STRUKTURËN E RENDITJES SË PUNËVE NË SHËRBIMIN
CIVIL, METODOLOGJINË PËRKATËSE DHE PËRSHKRIMIN PËRGJITHËSUES TË
ROLIT TË SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM NË KËTË SHËRBIM”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

1. Në fund të aneksit nr.2 të udhëzimit nr.1, datë 13.6.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Nëpunësit civilë të cilët kanë një Diplomë të Nivelit të Parë (DNP) në degët Inxhinieri Elektronike ose Informatikë, të emëruar deri në datën 1 prill 2010, sipas procedurave të legjislationit të shërbimit civil, në pozicione që lidhen me informatizimin e administratës publike e që u përkasin shkallëve 12,13,14,16 dhe 18, dhe që aktualisht vazhdojnë programet e studimeve të ciklit “Master i Nivelit të Parë” ose programet e studimeve të ciklit të dytë, të vazhdojnë të punojnë në pozicionet ku janë emëruar, me kushtin që, deri jo më shumë se dy vjet nga data e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, të pajisen me një diplomë Master i Nivelit të Parë (MNP), ose Diplomë e Nivelit të Dytë (DND).”.

2. Ngarkohen ministritë e linjës dhe Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha